# LIBËR PROTOKOLLI

Datë 26.06.2024

Nr. Prot. 56

Sot në sallën e Këshillit Bashkiak Devoll zhvillohet mbledhja e rradhës sipas njoftimit të datës 20.06.2024. Të pranishëm në sallë: G. Lakollari, I. Hoxha, V. Spaho, O. Çomka, T. Meraku, L. Çokani, A. Skoti, G. Demçolli, V. Kello, O. Mulla, K. Cenkolli, I. Çucka.

G.L: Vazhdojmë me pikën 1, Miratimi i rendit të ditës.

Hapet votimi: 12 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim.

G.L: Vazhdojmë me pikën 2, Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Hapet votimi: 12 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim.

G.L: Vazhdojmë me pikën 3, Projekt-vendimi Nr 36 datë 18.06.2024 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027.

Ky projekt vendim do të shtyhet për muajin tjetër pasi nuk janë specialistet përkatës dhe Këshilltarët kanë pyetje.

G.L: Vazhdojmë me pikën 4, Projekt Vendimi Nr 37 datë 20.06.2024 "Për kalimin në pronësi të trojeve të dhëna për qëllime ndërtimi nga bashkitë, ish komunat dhe ish këshillat e rretheve pas datës 10.08.1991 deri në hyrjen në fuqi të ligjit 24/2012 "Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij dhe për autorizimin e kryetarit të Bashkisë Devoll ose të autorizuarit ligjor të tij për lidhjen e kontratës përpara noterit për shitjen e trojeve të dhëna për ndërtim."

Nuk ka diskutime. Hapet votimi: 12 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim.

G.L: Vazhdojmë me pikën 5, Projekt Vendimi Nr 38 datë 20.06.2024.

Në sallë vjen Këshilltari, Vladimir Gjyli. Nuk ka diskutime

Hapet votimi: 13 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim.

G.L: Vazhdojmë me pikën 6 "Kërkesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.A për dhënie ~~[illegible]~~ mendimi të Këshillit Bashkiak në lidhje me ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të zeza.

G.L: Ne dje kishim edhe konsultime publike nga Ujësjellës Kanalizime Korçë ku ishim të pranishëm qytetarë, këshilltarë dhe ne diskutuam por sot meqenëse jemi dhe live duhet të tregohemi sa më transparentë me njerëzit dhe vendimet që do të marrim. Është aplikuar një çmim për tarifën e ujit, është unifikuar si rrjedhje mekanike ashtu dhe në rrjedhje të lirë. Deri dje ne kemi patur 3 çmime ku aty me rrjedhje të lirë ka qenë 25 lekë, rrjedhje mekanike 38 lekë në qytet dhe në disa fshatra 35 lek. Tarifa e ujit unifikohet dhe shkon 50 lek për të gjitha njësitë përfshirë Devollin.

Vlera e faturës sipas propozimit të rritjes për njësinë Devoll do jenë sipas zonave (Zona B, Devolli) Çmimi i ujit aktual është 30lek/m³, Çmimi i propozuar 50l, efekti i rritjes 12l, tarifë shërbimi aktuale, 50l me TVSH shkon 60l dhe tarifë shërbimi e propozuar është 200l, efekti i rritjes në muaj është 150l, ndikimi i rritjes në lekë është 222 lek + 44 lek TVSH = 266 lek total me TVSH. Këto janë tarifat e propozuara nga Ujësjellësi,

V. Kello: Tarifa e shërbimit për mua është paradoks, do rritet 4-fishi, kam një pyetje rritet kostoja e shërbimit të shpërndarjes, pra konsumatori më i madh është qyteti dhe shkon deri në depot shpërndarëse dhe rritet kostoja sepse janë rritur pagat e punonjësve, nga 60 në 43 punonjës, do të thotë për këtë bazohet me rritjen e çmimit dhe kosto për pagat mbetet e njëjtë. Ka shumë fshatra që bëjnë rrjedhje të lirë kështu që kostoja rritet.

I. Suka: Dje u shpjegua nga personat përkatës, mua më bën përshtypje pjesë e pasqyrimit këtu. Vërtet u theksua se tarifat e djeshme e dini për nuk e përmban metodologjia pjesën e diferencimit të tarifës për rrjedhje të lirë dhe rrjedhje mekanike. Realisht Devolli e ka pranuar dhe nuk e di që e kishin bazën ligjore, tek ishim në shkelje e mos të na e kishin vënë në dukje. Megjithëse dje u tha për shkelje nuk ka më një pagesë të tillë të diferencuar. Tani këtu pasqyro për banesë sjellës para ishte 33 l e ka vetëm qytetari që ka rrjedhje mekanike me pompë, në të zonave adm. e kemi 25 l. E di çfarë do të thotë t'i rritësh atyre komuniteteve të tjera nga 250 l të vejnë, që kalosh në $m^3$ 500 l. Tarifa e shërbimit është rritje shumë e madhe.

G. Demçolli: Që nga terminologjia, fjala rritje në rroshin në të mirë çdo qytetar duhet të merrte vesh çfarë po ndodh sepse donte një shpjegim të mirëfilltë, cilat janë arsyet e rritjes. Thatë që ujësjellësi në Devoll e zevin në të madh në 2023 ishte 3 bilion. Çfarë ndërtoi ky ujësjellës? Kanë bërë investime të reja? Është rritur popullata shërbimi? I bashkohem fjalës së prof Ladit nga pena kaq specifike si ujësjellës që kishin kaq dëshirë të menaxhojnë? (Oliver Kulla largohet nga salla)

Këshilltarët janë të gjithë kundër sepse rritja e çmimit të ujit dhe tarifës të shërbimit janë të larta dhe të papërballueshme nga qytetarët e Devollit.

G.L: Hapet votimi: 0 pro, 12 kundër, 0 abstenim. Nuk miratohet.

Vazhdojmë me "Të tjera": Raport për monitorimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2024. (4 mujori i parë)

Nuk ka diskutime.

Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Protokolluesi
Kostandina Braholli

Jany Hocka

Genti Lashollari